

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Sahit Krasniqi, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve profesional Ibrahim Idrizi dhe Arben Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të akuzuarit: K.K, për shkak të veprës penale vrasje nga neni 146 të KPK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.I-812-06/12 të dt.07 shkurt 2013, pas shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura me 23.01.2014, dhe me 14.04.2014 në prani të Prokurorit të shtetit Florije Salihu- Shamolli, të akuzuarit K.K dhe mbrojtësit të autorizuar të tij av. E.Sh, si dhe të dëmtuarit: F.H, më 16.04.2014 shpall dhe publikisht komunikoi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **K.K**, nga fshati Ll.. Komuna e Kaçanikut, i lindur, në Kaçanik, nga i ati N. dhe e ëma N., e gjinisë S, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, **gjendet ne paraburgim prej datës 22.10.2012.**

ËSHTË FAJTOR

-Sepse me datën 20.10.2012, rreth orës 20.45, në Kaçanik, me dashje e ka privuar nga jeta tani të ndjerin G.H, në atë mënyrë që gjersa tani i ndjeri G.H, ishte duke shkarkuar dru nga vetura "Kombi" së bashku me shokun e tij J.B pas pak kohe vjen i pandehuri K.K me R.R dhe Q.B, ku fillon fjalosja në mes të pandehurit K.K dhe tani të ndjerit G.H të cilët shkëmbejn fjalë fyese, pasi që pak më parë kishin pasur një bised telefonike të tensionuar në mesë vete dhe pas kësaj aty fillon përleshja në mes tyre ku i pandehuri për një moment rrëzohet në tokë nga shtyerja e tani të ndjerit i pandehuri arrin të ngrihet në këmbë dhe nga xhepi i jelekut nxjerrë një thikë flutër me të cilin e godet njherë në gjoks, në pjesën e majtë të ndjerit Q.B, ku si rezultat i traumës së pësuar nga veprimi i mjetit të mprehtë me mekanizëm mprehës, shpues dhe depërtues në hapsirën e majtë torakale me që rast tehu i thikës ka depërtuar në zemër si organ vital dhe ka shkaktuar

gjakderdhje në hapësirën e lirë torakale i cili në QKUK-në Prishtinë, të njejtën natë rreth orës 23.30 ndrron jetë,-

-me këtë kreu veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK-së.

Andaj gjykata në baze të dispozitave të përmendura dhe në bazë të nenit 3,5,6,11,15,34,36,38,64, dhe 73 të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së të **akuzuarin, K.K** e,

G J Y K O N

Me DENIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) viteve, në të cilin dënim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 22.10.2012, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.

Konform nenit 60 par. 1 të KPK-së, i shqiptohet dënimi plotësues-marrja e sendit me të cilën është kryer vepra penale dhe atë thika e markës flutur.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 150 euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pasi aktgjykimi të marr formën e prerë.

Familja e të ndjerit G.H dhe atë - prindi i tij **F.H**, në shqyrtimin gjyqësor nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës.

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për krime të rënda me aktakuzën PP.nr.I-812-06/12 të datës 07 shurt 2013, e ka akuzuar të akuzuarin K.K për shkak të veprës penale vrasje nga neni 178 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda-Kryetari i trupit gjykues duke vepruar në këtë çështje penale konform nenit 245 të KPPRK-së caktoi

dhe mbajti shqyrtimin fillestar me dt.22.11.2013, ku prokurori i shtetit Florije Salihu-Shamolli pas leximit të aktakuzës ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale vrasje nga neni 178 par. 1 të KPRK-së në veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK-së, pasi që në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në fuqi Kodi i vjetër Penal i Kosovës, i cili është më i favorshëm për të pandehurin.

Në shqyrtimin fillestar Kryetari i trupit gjykues, konform nenit 246 të KPPRK-së i ofron mundësinë të pandehurit të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm. Përkitazi me këtë i pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se i pranon veprimet e kryerjes së veprës penale por nuk e pranon fajësinë.

Kryetari i trupit gjykues konform nenit 254 të KPPRK-së me dt. 06.01.2014, për këtë qështje penale ka mbajtur **shqyrtimin e dytë** dhe pasi konstatoi se i pandehuri dhe mbrojtësi i autorizuar i tij av.E.Sh, para shqyrtimit të dytë, nuk kanë paraqitur kundërshtim me shkrim ndaj provave të caktuara në aktakuzë nga neni 249 të KPPK-së e as Kërkesë për hudhjen e aktakuzës nga neni 250 të KPPK-së, caktoi shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim për dt. 23.01.2014.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur para trupit gjykues me datën 23.01.2014 pasi që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, konform nenit 326 par.3 të KPPRK-së është proceduar me paraqitjen e fjalës hyrëse të palëve dhe me paraqitjen e provave, ku është ndëgjua dëshmitari - i dëmtuari F.H dhe dëshmitari J.B.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.14.04.2014, para fillimit të prezentimit të provave, mbrojtësi i autorizuar i të pandehurit av. E.Sh ka deklaruar: se i pandehuri K.K ka shprehur gadishmërinë që në këtë fazë të procedurës penale ta pranon fajësinë për veprën e kryer penale Vrasje nga neni 146 të KPK-së në të gjitha pikat e aktakuzës.

Pas deklaratës së mbrojtësit së të akuzuarit, Kryetari i trupit gjykues konform nenit 325 të KPPRK-së i jepë mundësinë të akuzuarit K.K që të deklarohej lidhur me pranimin ose mos pranimin e fajësisë, i cili deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale të Vrasjes nga neni 146 të KPK-së për të cilën e ngarkon aktakuza në të gjitha pikat e saj.

Fjala përfundimtare e palëve.

Prokurori i shtetit Florije Salihu- Shamolli ne fjalën përfundimtare ka deklaruar, se nga vetë pranimi i fajësisë së të akuzuarit K.K për veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK-së, i cili pranim përputhet në tërësi me të gjitha shkresat e lëndës si me deklaratat e dëshmitarve: J.B, R.R dhe Q.B si dhe me provat e tjera materiale siq janë: fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, raporti i autopsisë, vërtetohet qartë se i akuzuari me datë 20.10.2012 rreth orës 20.45 në Kaçanik e ka privuar nga jeta tani të ndjerin G.H dhe atë me një thikë, mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve trupore, me qka pas një goditje tani i ndjeri ka marrë plagë nga e cila plagë, të njejtën ditë në QKUK ndrron jetë. Andaj i ka propozuar trupit gjykues që të njejtin për këtë veprë penale ta shpall fajtorë dhe ta dënoj me dënim sipas ligjit. Njëherit i propozon gjykatës që me rastin e matjes së dënimit si rrethanë lehtësuese të merrë edhe pranimin e fajësisë, duke shtuar se i njejtë gjatë kohës sa ka qenë i mitur ka qenë recidivist i veprave të ndryshme penale, ndërsa tani si madhor për herë të parë akuzohet për një veprë të rëndë penale, dhe i propozon gjykatës që të njejtit të mos i ndërprehet masa e paraburgimit derisa aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Përfaqësuesi i të ndjerit G.H prindi F.H në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i bashkangjitet ndjekjes penale, i ka propozuar trupit gjykues që të akuzuarin K.K ta shpallë fajtor dhe ti shqipton dënimin e merituar për veprën e kryer penale, ndërsa nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro- juridike lidhur me këtë qështje penale

Mbrojtësi i autorizuar i të akuzuarit K.K, avokati E.Sh në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në këtë fazë të procedurës në të gjitha pikat e aktakuzës, dhe shikuar të gjitha rrethanat tregojnë faktin se i akuzuari veprën penale nuk e ka kryer me dashje direkte por me dashje eventuale, e cila rrethanë vërtetohet nga të gjitha shkresat e lëndës, ngase i akuzuari ka qenë në lidhje të fortë shoqërore me të ndjerin, se ata kanë qenë shokë shumë të ngushtë në mesë veti por rasti ka ndodhur aty për aty, se ditën kritike i akuzuari së bashku me disa shokë të tij pothuajse tërë ditën kanë konsumuar alkool në kafiteri të ndryshme dhe në momentin kur e ka kryer këtë veprë ka qenë në ndikimin e alkoolit, me që rast vetë tani i ndjeri ditën kritike e ka ftuar të akuzuarin që të i ndihmon në shkarkimin e druve. I ka propozuar trupit gjykues konformë nenit 21 të KPRK-së, këtë rrethanë ta merre si rrethanë lehtësuese, gjithashtu i ka propozuar gjykatës që gjatë shqiptimit të dënimit të i marrë parasysh edhe, rrethanën në të cilën është kryer kjo veprë penale, rrethanat personale të të akuzuarit si dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, motivin e kryerjes së veprës penale si dhe pranimin e

fajësisë nga ana e të akuzuarit në mënyrë vullnetare, andaj konform këtyre rrethanave i ka propozuar trupit gjykues që të akuzuarit të i shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari K.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij av. E.Sh, duke shtuar se për këtë veprë të kryer penale është penduar thellë, familjes së të ndjerit i kërkoj falje publikisht, dhe ka shprehë keqardhje për ngjarjen që ka ndodhur.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë së të akuzuarit.

Pasi që i akuzuari K.K në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet me aktakuzën e prokurorit të shtetit, gjykata konstatoi se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në nenin 248 par 1. të KPPK-së,

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë,
- pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. E.Sh
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantura nga prokurori i shtetit siq janë: raporti i autopsisë i lëshuar nga Departamenti i mjeksisë ligjore MA-.... në dhjetor të vitit 2012, dhe raporti i autopsisë i dt. 20.10.2012 si dhe fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës,
- aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit K.K.

Trupi gjykues pranoi rikualifikimin e veprës penale të prokurorit të shtetit nga vepra penale vrasje nga neni 178 par 1 të KPRK-së në veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK-së, pasi që në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në fuqi Kodi i vjetër Penal i Kosovës, i cili është më i favorshëm për të akuzuarin.

Nga spekti juridik trupi gjykues vlerëson se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasje, meqë me datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit me dashje e ka privuar nga jeta tani të ndjerin Q.B.

Përcaktimi i dënimit.

Trupi gjykues, me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit për të akuzuarin, pati parasysh të gjitha rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit të parapara në nenin 64 të KPK-së.

Si **rrethana lehtësuese** për të të akuzuarin pati parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, mënyren e kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, i cili ka patur sjellje korrekte, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën e kryer penale, është i moshës relativisht të re, ndërsa si **rrethana rënduese** për të akuzuarin trupi gjykues ka vlerësuar intensitetin e lartë të rrezikimit të vlerave të mbrojtura siç është jeta e njeriut, bartjen me vehte të mjetit të mprehtë shpues dhe depërtues (thikën flutur) me të cilin e ka kryer veprën penale, andaj mbi bazën e këtyre rrethanave, trupi gjykues të akuzuarit i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **11 (njëmbëdhjetë) viteve**, me bindje se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 34 i KPK-së, që të parandalojë të akuzuarin në të ardhmen në kryerjen e veprave penale (preventive speciale) dhe të përmbajë personat e tjerë në kryerjen e veprave të tilla të rrezikshme, pra do t'i shërbejë preventives gjenerale.

Llogaritja e paraburgimit, konfiskimi, shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesa pasurore juridike.

Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit iu është llogaritur koha e kaluar në paraburgim siç parashihet në nenin 73 par 1 të KPK-së.

Me aplikimin e nenit 393 par. 5 të KPPK-së, me aktvendim të veçantë të akuzuarit i është vazhduar paraburgimi derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar sipas këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 60 par. 1 të KPK-së, iu është shqiptuar dënimi plotësues marrja e sendit me të cilën është kryer vepra penale dhe atë thika e markës flutur.

Vendimi për shpenzimet e të paushallit gjyqësor në shumën prej 150 euro, është i bazuar në nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-se, e cila shumë është caktuar duke pasur

parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale dhe gjendjen ekonomike të akuzuarit.

Familja e të ndjerit G.H dhe atë - prindi i tij **F.H**, në shqyrtimin gjyqësor nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike, ndërsa iu ka bashkangjitur ndjekjes penale ndaj të akuzuarit

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR 37/2013 Me, 16.04.2014

Sekretarja juridike
Adelina Sallahu

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Sahit Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh pas pranimit te kopjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.